

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Q.I. nga fsh. S. K. Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-ës në bashkim real me veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë PP/II.nr.502/18 të datës 24.04.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **13.11.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj dhe të akuzuarit Q.I., me dt **14.11.2018** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Q. I.**, i biri i I. dhe i nënës Z. e gjinisë G, data e lindjes... në fsh. S. K Gj., ku edhe tani banon, ka të kryer shkollim universitar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 5 fëmijëve, me nr. ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- nga data e pavërtetuar e deri me **04.04.2018**, në fsh. S. K-Gj., konkretisht në shtëpinë e tij, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar dhen në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nën par 1.1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës dhe atë një (1) armë pistoletë me gaz të llojit Walthers me numër serik, një (1) karikator i të njëjtës armë, me datë 30.03.2018 në një aheng familjar të njëjtën armë e ka përdor duke shtënë 9 herë në ajër, derisa është njoftuar policia lidhur me rastin, ku nga zyrtarët policor është sekuestruar arma, karikatorit dhe 9 gëzhojat.

- me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 në bashkim real me veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6.17, 41, 49, 50, 51, 62, 73, 75, 76, nenit 374 par.1, nenit 375 para 1 të KPRK-se nenit 248 dhe 365 të KPPK-se, të akuzuarin e **gjykon me :**

DENIM ME KUSHT

Duke ja shqiptuar dënimin me burgim në kohë zgjatje **prej 14 muajve (katërmbëdhjetë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmarimit me dhunë.

Gjykata në kuptim të dispozitës 62 par.2 pika 7 lidhur me nenin 69 par.1 dhe nenit 375/3 të KPRK-ës, të akuzuarit, ia shqipton masën :

MARRJA E SENDEVE

I konfiskohet një (1) armë pistoletë me gaz të llojit Walther me numër serik si dhe një (1) karikator i të njëjtës armë komform nenit 375 prg.3 te KPRK-se, si objekt i kryerjes se veprës penale te sekuestruara me dt.04.04.2018.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.502/18 të datës 24.04.2018, e ka akuzuar të akuzuarin Q.I. nga fsh. S. K. Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi te paautorizuar të armëve nga 374par.1 në bashkim real me veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit A.Z. ,gjatë shqyrtimit fillestar me dt.13.11.2018, lexoi aktakuzën PP.nr.1113/17 të dt. 20.12.2017dhe deklaroi se mbeti ne tërësi pranë kësaj aktakuzës.

I akuzuari Q.I. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë ne çdo faze të procedurës jam penduar për veprat e kryera duke mos ditur se jam duke kryer vepre penale edhe pse asnjëherë nuk e kam keqpërdor armën-pistoletën me gazë e cilën e kam përdor gjatë ahengut familjar ne shenjë gëzimi por duke u kujdesur për rrethin dhe te tjerët . I propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur ne Gjykate, premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsëris veprën te tilla apo te ngjashme, gjendjen time te dobët ekonomike me qene se jam mbajtës i vetëm i familjes prej 7 anëtarësh si dhe faktin se asnjëherë me pare nuk kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari Q.I.: nga data e pavërtetuar e deri me 04.04.2018, në fsh. S. K-Gj., konkretisht në shtëpinë e tij , ka mbajtur në pronësi ,kontroll ose posedim të paautorizuar dhen në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nen par 1.1te Ligjit për Armët të Republikës se Kosovës dhe atë një (1) armë pistoletë me gaz të llojit Walther me numër serik..... , një (1) karikator i të njëjtës armë , me datë 30.03.2018 në një aheng familjar të njëjtën armë e ka përdor duke shtënë 9 herë në ajër , derisa është njoftuar policia lidhur me rastin , ku nga zyrtarët policor është sekuestruar arma , k arikator i dhe 9 gëzhajat.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza si raporti i i oficerit P. Sh. me PK10097 i dt. 30.03.2018,lista e armës dhe municionit të konfiskuar e dt. 04.04.2018, foto albumi i vendit të ngjarjes i dt. 04.04.2018 , foto dokumentacioni ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjesisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysht të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 5 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , pendimin e tij, , sjelljen korrekte në gjykim , premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata te akuzuarit Q.I. , i shqiptojë dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë)muajve, cili dënim nuk do te ekzekutohet po qe se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit ne afat prej 2(dy) viteve , nuk do te kryej ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimi i paraparë në dispozitën e nenit 41 dhe 49 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin një (1) armë pistoletë me gaz të llojit Walther me numër serik L155171116 si dhe një (1) karikator i të njëjtës armë komform nenit 375 prg.3 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.308/18 më datë 14.11.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** , nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.